



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 17.05.2019

PËR

MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË DETAJUAR TË ZONAVE ME RËNDËSI KOMBËTARE (PDZRK) GROPA E PORTËS, FUSHË OKOL DHE QAFË THORE NË AFËRSI TË FSHATIT BOGË, MALËSI E MADHE

Në mbështetje të neneve 7, 8, 9, 10, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me Propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të Nismës për hartimin e Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe, pjesë përbërëse e këtij vendimi, i cili përmban:
  - a) Nevojën dhe qëllimin për hartimin e PDZRK-së;
  - b) Kufijtë territorial të PDZRK-së;
  - c) Kufizimet dhe lejitimet e paracaktuara nga planet dhe vendimet në fuqi;
  - d) Fazat e hartimit të PDZRK-së dhe dokumentet përbërëse të tij;
  - e) Ekspertët/Fushat e ekspertizës dhe aktorët e grupit të punës që do të hartojnë PDZRK-në;
  - f) Plani i veprimeve për hartimin, bashkërendimin dhe këshillimin e dokumenteve të PDZRK-së;
  - g) Buxheti për hartimin e PDZRK-së;



2. Grupi i punës me ekspertë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Bashkia Malësi e Madhe, do të koordinojnë dhe monitorojnë procesin e hartimit të Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojnë punën për hartimin e dokumentit të PDZRK-së, bashkërendimin e këshillimin me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara, si dhe për paraqitjen për miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit, të dokumentit të Planit të Detajuar të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Gropa e Portës, Fushë Okol dhe Qafë Thore në afërsi të fshatit Bogë, Malësi e Madhe.
4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**

**MINISTËR I LINJËS**

**BLENDI KLOSI**



**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOPIA**

